



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:297692

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07023130

C.nr.4738/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S. I. nga P., të cilin e përfaqëson Pranvera A Zhara avokate në Pejë kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Pejë, në adresën rr. “Nëna Terezë”, pa numër, baza juridike, kompensim i rrezikshmërisë në vendin e punës dhe kompensim i pagës së 13-të nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit, 1000.00 €, jashtë seancës me datën 21.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET padia e paditësit S. I. nga P., e parashtruar me datë 26.12.2023, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Pejë, me objekt kontesti kompensim i rrezikshmërisë në vendin e punës dhe kompensim i pagës së 13-të nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1000.00 €, si e PA RREGULLUAR

A R S Y E T I M

Paditësi, përmes të autorizuarës së tij, më datë 26.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës, kompensim i rrezikshmërisë në vendin e punës dhe kompensim i pagës së 13-të nga marrëdhënia e punës, më vlere kontesti 1000.00€.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me aktvendimin e datës 25.10.2024 i ka kthyer në plotësim padinë paditëses, duke e detyruar që të rregullojë petitumin e padisë, duke përcaktuar saktë periudhën kohore nga cila datë deri në cilën datë kërkohet kompensimi në emër të rrezikshmërisë në punë, dhe sa është shuma për këtë kategori, si dhe sa është shuma në emër të pagës së 13- të, me njoftimin e pasojave procedurale se do të konsiderohet e tërhequr padia

nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor (3 ditë), ndërsa nëse i kthehet e pa plotësuar do të hedhet poshtë.

E autorizuar e paditëses, pas pranimit të këtij aktvendimi, ka dorëzuar parashtresën e datës 28.10.2024, në të cilën ka dorëzuar në gjykatë parashtresën në të cilën ka cek se: *Në këtë fazë të procedurës, është deklaruar se nuk është e mundur të bëhet precizimi i saktë i kërkespadiës, pasi sektorit të shëndetësisë asnjëherë më parë nuk i është paguar rrezikshmëria në vendin e punës. Për këtë arsye, është konsideruar e domosdoshme që gjatë shqyrtimit të çështjes të nxirret ekspertizë financiare, përmes së cilës do të llogaritet saktë shuma për kompensimin në emër të rrezikshmërisë në punë për punëtorët e shërbimit shëndetësor. Gjithashtu, është theksuar se pagat e 13-ta janë kërkuar me kamatë ligjore prej 8%, por në këtë fazë nuk është e mundur të bëhet precizimi i saktë i kërkesëpadiës për këtë pjesë. Në bazë të këtyre rrethanave, është propozuar që gjykata të caktojë seancën gjyqësore, ku do të mundësohet paraqitja e propozimeve dhe shqyrtimi i çështjes.*

Pas shqyrtimit të parashtresës, gjykata gjeti se i autorizuari i paditësit nuk ka vepruar në kuptim të aktvendimit për plotësimin e padisë, përkatësisht nuk e ka bërë plotësimin e parashtresës - padisë, sipas vërejtjeve - sugjerimeve si në aktvendimin e cekur më lartë, duke u njoftuar edhe për pasojat ligjore në rast të mos veprimit, pra parashtresa e dorëzuara nga ana e paditësit nuk e përmban kushtin e formës së shkruar si dhe çdo gjë që nevojitet që ta mundëson veprimin sipas saj.

Andaj, gjykata nga arsyet e cekura si më lartë e duke u mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 102.1 të LPK, *ku parashihet se kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet në par. 2 të nenit 99, gjykata do të thërras personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë, gjykata udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet dhe e cakton një periudhë 3 ditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtresës, ndërsa me dispozitën ligjore nga neni 102.3 të LPK-së, parashihet se do të konsiderohet e tërhequr parashtresa, po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në çoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtresa do të hedhet poshtë .*

Më dispozitat e nenit 142 të LPK -së, përcaktohet shprehimisht se: *"Gjykata jep vendime në seancë apo jashtë seance. Vendimet e gjykatës jepen në formë të aktgjykimit apo aktvendimit. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendos me anë të aktvendimit .*

Gjykata me rastin e vendosjes, vlerësoj edhe parashtresën e të autorizuarit të paditëses të quajtur plotësim i parashtresës, mirëpo edhe me plotësimin e parashtresës nuk është rregulluar kërkesa (petitumi) i padisë sipas udhëzimeve të gjykatës. Në këtë parashtresë me të cilën pretendohet se është bërë precizimi i kërkesëpadisë sa i përket "kërkesave për rrezikshmërisë në vendin e punës dhe kompensim i pagës së 13", pavarësisht kësaj nuk është precizuar kërkesa sa i përket shumës së kërkuar për pagën e 13 dhe rrezikshmëri dhe periudha kohore se nga cila datë deri në cilën datë kërkohen këto shuma, sepse jo domosdoshmërisht është e nevojshme marrja e provës me ekspertize financiare për të përcaktuar vlerën e kontestit, rrjedhimisht e paditura duhet të ketë para vetes një kërkesë të qartë në mënyrë që të deklarohet për të, andaj nën këto rrethana sipas vlerësimit të gjykatës kjo çështje nuk mund të procedohet tutje.

Bazuar në këtë dhe në mbështetje të dispozitave nga neni 99, 102, 390 e lidhur me nenin 387, e lidhur me nenin 142 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:297692, C.nr.4738/23, 21.03.2025**

Gj y q t a r i

Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.